REPUBLIKA E SHQIPERISE
LULEZIM FORTUZI
NOTER
TIRANE

# AKT - THEMELIMI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

## " GERTI - METAL "

### Neni 1

Bazuar ne ligjin 7667 dt 28.1.1993 per regjistrimin tregetar dhe formalitet qe duhen respektuar nga Shoqeria Tregetare une Gerti Shanaj i biri i Shyqos dtl. 1967 lindur ne Vlore e banues ne Tirane Rr, Punetoret e Rilindjes Nr.8 vendos sot me dt. 9.2.1995 per krijimin e Shoqerise Private SH.P. K. "GERTI METAL" me kushtet qe vijon :

### Neni 2

Vende qendrimi i shoqerise do te jete ne Tirane Rr. Punetoret e Rilindjes Nr.8, shoqeria munde te hape dhe vende qendrime te tjera dhe ne rrethe te tjera te vendit sipas shtrirjes se saj ekonomike.

### Neni 3

Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj mbi 10 vjet te njepasnjeshme.

### Neni 4

Objekti i veprimtarise private te Shoqerise do te jete :

Eksport import me shumice e pakice, mallra industriale, ushqimore, mallra metale me ngjyra, elektro shtepiake, nafte e produktet e saj, bituminoze, krip lende drusore e pastrim ambienti.

### Neni 5

Ne fillim te veprimtarise ekonomiko financiare shoqeria disponon nje kapital themelor prej 100 000 lekesh.

### Neni 6

Kapitali i shoqerise mund te shtohet sipas rritjes ekonomike te saj, te ardhurat do te sigurohen nepermjet veprimtarise private te percaktuar ne nenin kater te ketij akti themelimi.

Neni 7

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontrate zbatohen dispozitat e legjislacionit Shqiptar te punes.

Neni 8

Organet drejtuese te ShPK. "Gerti Metal" do te jete administratori qe vendos per gjithcka qe ka te beje me veprimtarine e shoqerise gjithashtu do te jete asambleja si organ keshillimor si dhe drejtori i Pergjithshem si organ ekzekutiv.

Te drejtat dhe detyrat e administratorit drejterit te Pergjithshem dhe te asamvlese percaktohen ne statutin e shoqerise qe i bashkangjitet ketij akti themelimi Administratori eshte vete themelu si i Shoqerise Z. Gerti Shanaj.

Neni 9

Veprimet financiare me te tretet do te kryhen nepermjet Bankes ku shoqeria do te kete numer te saj llogarie. Per te sigursar veprimtari te rregullt shoqeria do te aplikoj kontabilitetin dhe do te nxjerr Bilancin Financiar sipas dispozitave ne Fuqi. Viti financiar mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti.

Neni 10

Per mosmarveshjet qe mund te lindin midis themeluesit te shoqerise dhe personave te trete si dhe persona te tjere fizik apo juridik apo te marre ne pune sipas kontrates se punes do te zgjidhen me mirkuptim, ne raste te kundert ruhet e drejta e zgjidhejs se tyre ne gjykate sipas statut te shoqerise dhe te ketij akti themelimi si dhe kontrates se punes ku do te zbatohen kerkesat e legjislacionit te punes ne fuqi.

Neni 11

Shoqeria ka per detyre te zbatoje rregullat dhe udhezimet e inspektoriateve te ndryshme si ai financiar, sigurimi teknik, higjeno sanitar etj.

Neni 12

Ne raste shperndarje te shoqerise likujdimi i saj do te behet ne baze te rregullave qe percaktohen ne statut dhe ne ligjin per Shoqerite tregetare.

Neni 13

Shoqeria ka vulen e saj, vula eshte e rrumbullaket me madhesi te zakonshme ku rreth e qarke saj shenohet SH.P.K. Tirane Albania dhe ne mes ka sigle Gerti Shanaj

Neni 14

Akti i themelimit eshte hartuar ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per tu depozituar prane organeve perkatese shteterore dhe nje kopje ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ky akt themelimi hyn ne fuqi pasi nenshkruhet nga themeluesi i tij.

Akti i themelimit u nenshkrua sot me dt. 9.2.1995 ne Tirane .

T h e m e l u e s i

( Gerti Shanaj )

S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K.)

" GERTI METAL "

SH.P.K. "GERTI METAL " krijohet mbi bazen e iniciative dhe kapitalit te Gerti Shanaj ortak i vetem lindur ne Vlore e banues ne Tirane Rruga Punetoret e Rilindjes Nr.8 i cili veç aktit te themelimit harton dhe nenshkruan dhe statutin e Shoqerise me kete Permbatje.

Kreu i I

Dispozita te Pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar "Gerti Metal" Tirane ne perputhje me aktin e themelimit te saj dhe te legjislacionit Shqiptar ne kete statut rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te te punesuarve si dhe i jepen te dhena me rendesi per organizimin dhe objektin e Shoqerise si dhe çeshtje te tjera qe lidhen me punen e saj.

Neni 2

Shoqeria "Gerti Metal" krijohet me mjetet vetiake te themeluesit te saj me karakter prone private.

Neni 3

Shoqeria nga neni 1 i ketij statuti do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin SH.P.K. "GERTI METAL".

Neni 4

Shoqeria ka statusin e personit juridik.

Neni 5

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane Rr. Punetoret e Rilindjes Nr.8.

Neni 6

Objekti i veprimtarise private te SH.P.K. "GERTI METAL" do te jete :

Eksport import me shumice e pakice te mallrave industrial, ushqimore, mallra metal me ngjyra, elektro shtepiake, nafte e produktet e saj, bituminoze, kripe lende drusore e pastrim ambienti.

Neni 7

Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj te percaktuar ne kete statut ne teritorin e Tiranes. Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te çele dege o zyrat e saj te perfaqesimit edhe ne rrethe te tjera te vendit.

Neni 8

Shoqeria e kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin duke u mbeshtetur ne parimet e likujditetit sigurise dhe rentabilitetit.

Kreu i II

Kushtet Ekonomike

Neni 9

Veprimtaria e Shoqerise realizohet ne baze te parimevo te llogarise dhe pasqyrohet ne Bilancet e saj.

Neni 10

Per te bere te mundur zhvillimin e vepristarise se shoqerise caktohet nje kapitalthemelor prej 100 000 lekesh . Kapitali depozitohet ne Banke nga administratori ku çelet numeri i llogarise per shoqerine.

Neni 11

Shoqeria ne emer te vete eshte pronare disponuese dhe perdoruese e pasurive te saj, por i ushtron ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe ajo kryen. Shoqeria mund te bleje pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te afroj per garanci edhe pasurite e saj per te marre kredi bankare.

Neni 12

Shoqeria krijon Fondin Rezerve dhe fonde te tjera te veçanta financimi per zhvillimin e rritjen ekonomike te saj. Shoqeria i disponon plotesisht mjetet e veta financiare, detyrimet eventuale qe mund te lindin gjate vepristarise se saj mbulohen nga fondi rezerve, nga fonde te tjera ose nga shumat suplementare qe mund te derdhe themeluesi i saj.

Kreu i III

Administrimi

Neni 13

Organi vendimor i shoqerise eshte administratori i cili vendos per te gjitha ceshtjet qe merr ne shqyrtim gjate veprimtarise se shoqerise si per Bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin ose pakesimin e kapitalit themelor , per caktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise, per emerimin e drejtorit te pergjithshem dhe te anetareve te asamblese si organ keshillimor, per shkrirjen ose mbylljen e shoqerise etj. Administrator eshte Gerti Shanaj.

Vec sa thame le larte administratori ka keto kopetenca :

- Te perfaqesoje shoqerine kundrejt te treteve brenda caqeve te veprimtarise se Shoqerise si dhe te veproje ne mardhenie me organet shteterore ne te gjitha rrethanat
- Te miraroje planet e llogarite ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te perzgjedh ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit.
- Te percaktoje numerin e punonjesve ne shoqeri dhe pagat e tyre.

Neni 14

Per mbarvajtjen e veprimtarisese shoqerise krijohet asambleja e shoqerise si organ keshillimor. Ne te bejne pjese persona te zgjedhur nga administratori. Asambleja ka per detyre ti beje propozim administratorit si per programin e veprimtarise dhe te zhvillimit te shoqerise, per ndryshime eventuale ne statut, per ndryshimin e formes se organizimit te shoqerise, dhe ka per detyre te ndihmoje ne zbatimin e vendimeve qe merr administratori.

Neni 15

Veprimtaria administrative e shoqerise administrohet nga drejtori i Pergjithshem i cili perben organin ekzekutiv. Drejtori i pergjithshem ne kuadrin e kopetencave te tij te percaktuar ne kete statut dhe nga vendimet qe merr administratori vepron ne te gjithe sektoret e shoqerise per ndjekjen dhe realizimin e veprimtarise se

shoqerise te percaktuar ne objektin e saj. Drejtori i Pergjithshem i shoqerise ka keto detyra kryesore :

- Organizon dhe kontrollon punen per zbatimin e detyrave qe rrjedhin nga planet ekonomike e financiare te shoqerise.

- Ndjek zbatimin konkret te vendimeve te administratorit, administron vepritmtarine e filjaleve, perfaqesive ose degeve me prokura ose sipas vendimit te administratorit,.

- Nenshkruan kontrata ne emer dhe per llogeri te shoqerise me perjashtim te atyre qe lidhen nga vete administratori.

- Raporton para administratorit dhe pergjigjet perpara tij per veprimtarine e shoqerise ne kuadrin e kopetencave te tij.

Kreku i IV

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqrrise

Neni 16

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet per nje periudhe prej 10 vjet te njepasnjeshme.

Kreu i V

Mardheniet e Punes

Neni 17

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen neperputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete statut.

Neni 18

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive te punes. Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje :

Kushtet dhe menyra e mardhenies se punes, koha e punes, puna e nates,puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor dhe te festave zyrtare,mbrojtja ne pune, pushimi i mardhenieve te punes, paga e punes se punonjesit dhe shperblime te tjera.

Kreu i VI

Mbyllja e shoqerise

Neni 19

Veprimtaria e shoqerise mbaron me afatin e percaktuar ne aktin e themelimit ose dhe me pare kur gjate dy viteve te njepasnjeshen veprimtaria e saj rezulton jo rentabel. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Neni 20

Kur shoqeria likujdohet administratori emeron komisionin e likujdimit i cili paryqet per miratim bilancin e likujdimit te shoqerise. Shoqeria i jep funde veprimtarise se saj ne qastin e miratimit te bilancit te likujdimit.

Neni 21

Mjetet financiare si dhe çdo pasuri tjeter e fituar si rezltat i veprimtarise se shoqerise kur shoqeria likujdohet i takojne themeluesit te shoqerise pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 22

Ky statut hartohet ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per tu depozituar prane organeve perkatose shteterore dhe nje kopje per dokumentacionin baze te Shoqerise.

Firmosrt sot me dt. 9.2.1995 nga themeluesi i saj.

T H E M E L U E S I

( GENTI SHANAJ )